



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM Nr.171, datë 11.09.2019

### PËR SKUALIFIKIMIN DHE PËRJASHTIMIN E KANDIDATIT Z. {...} NGA PROCEDURA E EMËRIMIT NË GJYKATËN E LARTË

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 11.09.2019, pasi u njoh me materialet e çështjes dhe Relacionin “Për gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, të kandidatit z. {...}”, përgatitur nga relatori z. Alban Toro, si dhe pasi shqyrtoi propozimin për skualifikimin dhe përjashtimin e kandidatit z. {...} nga procedura e emërimit në Gjykatën e Lartë,

### VËREN

#### I. PROCEDURA E VERIFIKIMIT

1. Me Vendimin nr.110, datë 09.07.2019, mbështetur në nenin 136 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 48, pikat 3/c dhe 5, si dhe nenin 49 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si edhe në nenin 31, pika 1, të Ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, **Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur: “Shpalljen e procedurës së emërimit në Gjykatën e Lartë dhe bërjen e thirrjes për paraqitjen e kandidaturave, nga radhët e juristëve të spikatur, për një pozicion të lirë, që plotësojnë kërkesat specifike për ekspertizë të veçantë në fushën e të drejtës penale”.**
2. Brenda afatit të përcaktuar dyjavor nga dita e publikimit të vendimit si më lart në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. {...} ka aplikuar për të marrë pjesë në procedurën e konkurimit për pozicionin e lirë të shpallur përmes vendimit të mësipërm.
3. Me Vendimin nr.142, datë 26.07.2019, bazuar në nenin 49 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në Vendimin e tij nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë” (më poshtë referuar si Vendimi 75/2019), **Këshilli i Lartë Gjyqësor ka**

vendosur: **“Fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për kandidatët, nga radhët e juristëve të spikatur, për në pozicionet e lira në Gjykatën e Lartë”** (pika 1). Po me këtë vendim (pika 2 - 22), pas shortit të hedhur, për procedurën e verifikimit për kandidatin, z. {...}, është caktuar si relator **z. Alban Toro**.

4. **Më datë 26.07.2019**, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në Seksionin A, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, relatori i çështjes, në rrugë elektronike, njoftoi kandidatin për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit; - caktimin e relatorit të kësaj procedure verifikimi, të drejtën që kishte për të kërkuar përjashtimin e relatorit të caktuar dhe/ose të çdo anëtar tjetër të Këshillit, brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e këtij njoftimi. Po ashtu, kandidati u njoftua edhe për detyrimin për plotësimin e formularit deklarues për adresën postare, adresën elektronike dhe kontaktit telefonik, për qëllimet e procedurës së verifikimit ndaj tij, formular ky që i është bashkëngjitur njoftimit.
5. **Brenda afatit tre ditor**, kandidati depozitoi rregullisht të plotësuar formularin deklarues për adresën postare, adresën elektronike dhe kontaktit telefonik, për qëllimet e procedurës së verifikimit ndaj saj. Nga ana tjetër, në këtë afat, kandidati nuk parashtrroi asnjë pretendim në lidhje me relatorin e caktuar për procedurën e verifikimit ndaj saj apo për ndonjë anëtar tjetër të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
6. **Më datë 29.07.2019**, pas shqyrtimit paraprak të dokumentacionit të paraqitur në rastin e kandidimit, duke vlerësuar se ky dokumentacion ishte i mangët apo jo konform ligjit (origjinal ose i njëzuar me origjinalin), relatori i çështjes, në rrugë elektronike, njoftoi kandidatin për plotësimin e dokumentacionit të kandidimit, bazuar në pikën 9, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019.
7. **Po më datë 29.07.2019**, bazuar në pikën 8, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, relatori i çështjes, në rrugë elektronike, i dërgoi kandidates formularët dhe autorizimet përkatëse (të përcaktuara në pikën 6, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019) që duhet të plotësoheshin dhe dorëzoheshin prej saj në kuadër të procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit.
8. **Brenda afatit pesë ditor**, kandidati depozitoi rregullisht dokumentacionin e kërkuar të kandidimit.
9. **Më datë 28.08.2019** kandidati me anë të njoftimit elektronike i drejtohet relatorit me subjekt **“dërgimi i dokumenteve dhe shpjegimeve shtesë “**, me anë të së cilës ai interpreton ndër të tjera se **“..Omissis.. nga formulimi dhe interpretimi gramatikor i nenit 49/1 dhe 49/2, të ligjit nr. 96 / 2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nga të cilat rezulton se, nga përdorimi i fjalës mund, 1/5 e anëtarëve të Gjykatës së Lartë parashikohet të zgjidhen nga jo gjyqtarët ku përfshihen juristët e spikatur, por jo vetëm pasi kjo e drejtë i njihet edhe subjekteve të tjerë jogjyqtarë dhe ndër këta të fundit që plotësojnë kriteret ligjore janë vetëm magistratët jogjyqtarë, pra prokurorët, ndërkohë që kushti i gradës shkencore për kandidim, i përcaktuar në nenin 49/1 të ligjit nr. 96 / 2016, i referohet vetëm kandidatëve juristë të spikatur dhe jo magistratëve jogjyqtarë, që gëzojnë tjetër status. Kësaj kategorie të fundit, pra magistratëve, i**

referohet neni 49/2 i ligjit nr. 96 / 2016, që parashikon plotësimin prej tyre vetëm të kritereve të germave përkatëse të nenit 28 të ligjit, dhe jo kushtit të gradës shkencore në drejtësi sipas nenit 49/1 të atij ligji...”.

10. Në vijim të procedurës së verifikimit, **më datë 06.08.2019**, bazuar në pikën 10, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, përmes shkresave të veçanta, relatori i çështjes kërkoi informacion dhe raportim nga institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës, për kandidatët e Gjykatës së Lartë, ndër ta edhe për z. {...}.

11. Në vijim të konstatimit të mungesës në mënyrë shteruese të dokumentit “**gradë shkencore në drejtësi**” sipas nenit 136 pike 3 e Kushtetutës si edhe administrimit të shpjegimeve të kandidatit i cili e konfirmonte këtë mungesë, por duke e interpretuar se disponimi i titullit “**magjistrat**” nënkupton plotësimin e kushtit ligjor për kandidimin si anëtar jo gjyqtar, relatori procedoi me informimin e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës .

12. Informimi për mungesën e gradës shkencore të kandidatit, kryhej pasi në vështrim të nenit 136, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe të nenit 49, pika 1, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, mund të përbënte një rrethanë që mund të çonte në përfundimin se kandidati nuk plotësonte një nga kushtet e emërimit si gjyqtar në Gjykatën e Lartë. Më tej Komisionin e Zhvillimit të Karrierës, mbështetur në shkronjën “a”, pika 12, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, me Vendimin e datës 06.09.2019, vendosi që: “Kandidati z. {...} të ftohet për të paraqitur shpjegime lidhur me gjetjen e procedurës së verifikimit, si edhe të çdo dokumentacioni mbështetës të nevojshëm sipas vlerësimit të tij”.

13. Mbi këtë bazë, **më datë 06.09.2019**, relatori i çështjes, në rrugë elektronike, njoftoi kandidatin **për gjetjen e procedurës së verifikimit**, pra në lidhje me kushtin e kandidimit “**të mbajtjes gradë shkencore në drejtësi**”, duke e ftuar për të paraqitur shpjegime për gjetjen e procedurës së verifikimit, si edhe çdo dokumentacion mbështetës të nevojshëm sipas vlerësimit të tij.

14. Brenda afatit pesë ditor, më **datë 09.09.2019**, në rrugë elektronike dhe me poste, kandidati paraqiti shpjegimet e tij ku ndër të tjera evidenton se “...*Omissis...subjekti prokuror sikurse është rasti i konkurrimit tim, ndonëse nuk përmendet nominalisht në Kushtetutë, në ligj dhe aktet nënligjore si një ndër subjektet që mund të kandidojë për në pozicionin e anëtarit të Gjykatës së Lartë, legjitimohet të konkurrojë për këtë pozicion për arsye themelore të tilla si : --Një pengesë në këtë konkurrim do të përbente cenim të parimeve kushtetuese të përcaktuar në nenet 17 dhe 18 të Kushtetutës .- se dyti sepse 1/5 e vendeve të anëtareve të Gjykatës e Larë plotësohen nga jo gjyqtaret, dhe kjo e fundit është një bashkësi më e madhe subjektsh se ajo e juristëve të spikatur, të cituar nominalisht dhe në një mënyrë shteruese në nenin 49/1 të ligjit nr.96/2016. -Se dyti sepse për subjektin prokuror, që gëzon statusin e magjistratit dhe ka mbi 15 vjet përvojë në drejtësinë penale, nuk është kusht “sine qua non” grada shkencore në drejtësi për konkurrimin për pozicionin e anëtarit të Gjykatës së Lartë, në dallim nga kategoria e juristëve të fushave të tjera, të cilët duhet të vlerësohen edhe si të spikatur në kuptim të përcaktimit kushtetueseligjor....omissis..”.*

15. Pas marrjes së shpjegimeve nga kandidati, duke vlerësuar të plota procedurën e verifikimit të ndjekur deri në këtë moment dhe, në veçanti, verifikimet në lidhje me kushtin e kandidimit “të

mbajtjes gradë shkencore në drejtësi”, mbi konsideratën se në rastin konkret verifikohet një rrethanë që ishte e aftë për të pasjellë skualifikimin e kandidatit nga procedura e emërimit, **relatori** i çështjes ia parashtrori rastin Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.

16. Në mbledhjen e datës 09.09.2019, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, duke konsideruar të plota procedurat dhe verifikimet për këtë kusht kandidimi për z. {...}, bazuar në pikën 3, të Seksionit C, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, **vendosi** kalimin e çështjes për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor për të vlerësuar dhe vendosur për skualifikimin e kandidatit për mosplotësimin e këtij kushti kandidimi ose për vijimin e procedurës së verifikimit për kushtet dhe kriteret e tjera ligjore të kandidimit.

## **II. GJETJA E PROCEDURËS SË VERIFIKIMIT DHE VLERËSIMI I SAJ**

Pas administrimit të dokumentacionit ligjor dhe në mënyrë të veçantë nga shpjegimet e detajuara që ka dhënë kandidati z. {...}, gjatë procedurës së verifikimit në analizë të nenit 136, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 49, pika 1, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, u konstatua se ekziston një rrethanë që nuk lejon kualifikimin pasi kandidati nuk plotëson një nga kushtet e emërimit si gjyqtar në Gjykatën e Lartë.

Sipas nenit 136, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, “*Gjyqtari i Gjykatës së Lartë zgjidhet nga radhët e gjyqtarëve me të paktën 13 vjet përvojë në ushtrimin e profesionit. Një e pesta e gjyqtarëve në këtë gjykatë përzgjidhet mes juristëve të spikatur me jo më pak se 15 vjet përvojë si avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, juristë të nivelit të lartë në administratën publike ose në fusha të tjera të së drejtës. **Kandidatët që përzgjidhen nga radhët e juristëve duhet të kenë gradë shkencore në drejtësi**”.*

3. Sipas nenit 49, pika 1, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, “*Një e pesta e gjyqtarëve në Gjykatën e Lartë mund të përzgjidhen mes juristëve të spikatur, që kanë gradë shkencore në drejtësi, me jo më pak se 15 vjet përvojë si avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, juristë të nivelit të lartë në administratën publike ose në fusha të tjera të së drejtës*”.

4. Nisur nga fakti që vërtetohet, si dhe në referim të ligjit të zbatueshëm, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se kandidati, z. {...}, nuk plotëson kushtin e kandidimit të përcaktuar në nenin 136, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në nenin 49, pika 1, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, atë të mbajtjes se gradës shkencore në drejtësi,

5. Po ashtu, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson të rregullta dhe të plota procedurat e verifikimit të ndjekura deri në këtë moment për z. {...}, në veçanti verifikimet sa i përket këtij kushti kandidimi.

## **III. PRETENDIMET E KANDIDATIT DHE VLERËSIMI I TYRE**

**1. Në shpjegimet e tij, kandidati, z. {...}, ka parashtruar ndër të tjera se :** *“Omissis.. , prokurori që gëzon cilësinë e magjistratit dhe ka të paktën 15 vjet vjetërsi në detyrë, nuk mund ti mohohet e drejta për të kandiduar për të plotësuar 1/5 e vendeve nga jo gjyqtarët në Gjykatën e Lartë, pasi jo vetëm që kjo e drejtë buron nga kuptimi dhe interpretimi i neneve 136/3 dhe 136/4 të Kushtetutës, si dhe neneve 2/gj, 47/1-a, 48/1, 48/3-a, 48/3-c, 49/1, 49/2 dhe 164/1 të ligjit nr. 96 / 2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, por e kundërta do të përbënte diskriminim kushtetues sipas neneve 17/1 dhe 18 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Konkurrimi i prokurorit si magjistrat jogjyqtarë për të plotësuar 1/5 e vendeve nga jo gjyqtarët në Gjykatën e Lartë, nuk vjen nga asnjë prej fushave shteruese të së drejtës prej nga vijnë juristët e spikatur, sipas parashikimit të nenit 49/1, të ligjit nr. 96 / 2016, sepse funksioni i prokurorit është i papajtueshëm ligjërish me to dhe, sipas nenit 148/3 të Kushtetutës, Prokuroria funksionon vetëm pranë sistemit gjyqësor, kurse statusi i gjyqtarëve dhe prokurorëve rregullohet në të njëjtin ligj, çka nuk rezulton për juristët e spikatur. Prokurori që gëzon statusin e magjistratit (jo gjyqtar), sipas nenit 164/1 të ligjit nr. 96 / 2016 dhe njëkohësisht ka mbi 15 vjet vjetërsi në detyrë, i plotëson kushtet ligjore për kandidimin si anëtar jo-gjyqtar i Gjykatës së Lartë, bazuar në nenet 136/3 dhe 136/4-1 të Kushtetutës, si dhe nenet 2/gj, 47/1-a, 48/1, 48/3-a, 49/1, 49/2 dhe 164/1 të ligjit nr. 96 / 2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” edhe pse nuk ka gradë shkencore në drejtësi, pasi ai nuk konkurren me statusin e juristit të spikatur, kategori për të cilën është kusht i domosdoshëm grada shkencore, por me një status të ndryshëm dhe pikërisht atë të magjistratit jo gjyqtar sipas nenit 48/3-a të ligjit nr. 96 / 2016, status të cilin subjekti im e ka fituar për shkak të ligjit me datë 21.03.2019, kur ka marrë formë të prerë vendimi për rivlerësimin kalimtar...”*

**2. Këshilli i Lartë Gjyqësor çmon të pabazuara pretendimet e kandidatit, z {...}, se për shkak të disponimit të statusit “magjistrat”, grada shkencore në drejtësi nuk duhet të konsideruar si kriter kualifikues.**

2.1 Konkretisht, sikurse rezulton nga aktet e administruar gjatë hetimit administrativ por edhe nga konfirmimi që kandidati pranon në shpjegimet e tij rezulton se ai nuk e ka gradën shkencore në drejtësi.

2.2 Këshilli i Lartë Gjyqësor çmon të pa bazuar pretendimin e kandidatit për konkurrimin e tij si magjistrat jo gjyqtar dhe jo si jurist spikatur dhe për këtë shkak “grada shkencore në drejtësi” nuk mund të jetë kusht kualifikues.

2.3 Në këtë konkluzion Këshilli i Lartë Gjyqësorë ka arritur pasi ka marrë në vlerësim dispozitat Kushtetuese dhe ato ligjore me qëllim identifikimin e frymës dhe qëllimit të kushtetutë bërësit në lidhje me përzgjedhjen aktuale te anëtarit të Gjykatës së Lartë.

2.4 Ne nenin 136 te Kushtetues se Republikës së Shqipërisë është përcaktuar ndër të tjera se:

*“Gjyqtari i Gjykatës së Lartë zgjidhet nga radhët e gjyqtareve me të paktën 13 vjet përvojë në ushtrimin e profesionit. Një e pesta e gjyqtareve në këtë gjykatë përzgjidhen mes juristeve të spikatur me jo me pak se 15 vjet përvojë si avokatë, profesorë ose lektore të së drejtës, juristë të*

*nivelit të lartë në administratën publike ose në fusha të tjera të së drejtës. Kandidatet që përzgjidhen nga radhët e juristeve duhet të kenë grade shkencore në drejtësi; Kandidati jo gjyqtar nuk duhet të ketë mbajtur funksione politike në administratën publike, ose pozicione drejtuese në parti politike, gjatë 10 viteve të fundit para kandidimit. Kriteria të tjera dhe procedura e përzgjedhjes së gjyqtarit parashikohet me ligj...omissis”.*

2.5 Ligji nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si pjesë e paketës së reformës në drejtësi, përmban rregullime ligjore jo vetëm mbi të drejtat dhe detyrimet e magistratëve, zhvillimin e karrierës dhe mbarimin e mandatit, vlerësimin etik dhe profesional, përgjegjësinë disiplinore, penale dhe civile por edhe pranimin dhe emërimin e tyre në sistemin gjyqësorë në përgjithësi dhe në mënyrë të veçantë në Gjykatën e Lartë.

Neni 28 i ligjit të sipërcituar përmban disa nga kriteret ligjore të detyrueshme që kandidati duhet të ketë në rastin e konkurrimit për një pozicion të lirë në Gjykatën e Lartë dhe konkretisht :

- a) ka zotësi të plotë për të vepruar;
- b) është shtetas shqiptar;
- d) nuk është dënuar me vendim penal të formës së prerë;
- dh) nuk është larguar nga detyra për shkaqe disiplinore, si dhe nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- ë) nuk ka qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Sigurimi i Shtetit përpara vitit 1990;
- f) nuk ka qenë bashkëpunëtor, informator, ose agjent i shërbimeve sekrete.

Në nenin 49 përcaktohen kriteret ligjore dhe procedurën e përzgjedhjes së gjyqtarit jo magistrat në Gjykatën e Lartë.

Më konkretisht ai përcakton se:

“ Një e pesta e gjyqtarëve në Gjykatën e Lartë mund të përzgjidhen mes juristëve të spikatur, që kanë gradë shkencore në drejtësi, me jo më pak se 15 vjet përvojë si avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, juristë të nivelit të lartë në administratën publike ose në fusha të tjera të së drejtës.

2. Kandidatët jo gjyqtarë për pozicione në Gjykatën e Lartë duhet:

- a) të plotësojnë kriteret e përcaktuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “ë” dhe “f”, të nenit 28, të këtij ligji;
- b) të mos kenë mbajtur funksione politike në administratën publike, ose në pozicione drejtuese në parti politike, gjatë dhjetë viteve të fundit para kandidimit.

3. Kandidati që ka njohuri të një gjuhe të një shteti anëtar të Bashkimit Europian ka përparësi në vlerësim.

4. Këshilli i Lartë Gjyqësor publikon thirrjen për paraqitjen e kandidaturave, në përputhje me përcaktimet e bëra në pikat 3 dhe 5, të nenit 48, të këtij ligji.

5. Këshilli vlerëson përmbushjen e kriterëve, sipas parashikimeve të pikës 2, të këtij neni, dhe verifikon kandidatët, sipas parashikimeve të **pikave 2 deri në 7, të nenit 32, të këtij ligji.** Kandidatët, të cilët nuk përmbushin kriteret ose nuk kalojnë procesin e verifikimit të pasurisë dhe të figurës, përjashtohen nga kandidimi”.

2.6.Nga interpretimi i dispozitive Kushtetues dhe atyre të posaçëm, **lex specialis**, rezultojnë se ligji ka parashikuar kategorizimin/përbërjen e gjyqtarëve në Gjykatën e Lartë në dy lloje të ndryshme duke vendosur në përputhje me to kritere ligjore kualifikimi dhe metodologji të ndryshme vlerësimi me qëllim përshtatjen e përvojës së kandidatëve nga kategoria nga e cila vijnë.

2.7.Në kategorinë e parë përfshihen **vetëm** magjistratët “**GJYQTARE**” (neni 136 i Kushtetutës) për të cilët Kushtetuta ka parashikuar minimumin e viteve të përvojës si magjistratë, (**me të paktën 13 vjet përvojë në ushtrimin e profesionit**), dhe më pas ligjvënësi në nenin 48 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” parashikon një sistem rregullash jo vetëm për vlerësimin individual të tyre por edhe për ngritjen në detyrë e cila konsiderohet ndër të tjera si “...omissis. Kalimi nga një pozicion në sistemin gjyqësor ose të prokurorisë, në një pozicion tjetër të një niveli më të lartë”, duke përfshirë në të edhe emërimin në Gjykatë.

2.8.Në kategorinë e dytë të përbërjes së Gjykatës së Lartë dispozitat Kushtetuese kanë përcaktuar në formulë prurje nga kandidatë të cilësuar si “**JURISTE TE SPIKATUR**” me përvojë të përqendruar avokati, veprimtari mësimdhënie/akademi, juristë të nivelit të lartë në administratën publike ose në fusha të tjera të së drejtës.

2. 9.Raporti i kësaj kategori është përcaktuar në masën 1/5 e numrit të përgjithshëm gjyqtarëve të kësaj gjykate dhe si kritere minimumi vjetërsinë 15 vjet dhe gradën shkencore në drejtësi, (**një e pesta e gjyqtarëve në këtë gjykatë përzgjidhen mes juristeve të spikatur me jo me pak se 15 vjet përvojë si avokatë, profesorë ose lektore të së drejtës, juristë të nivelit të lartë në administratën publike ose në fusha të tjera të së drejtës**). Gjithashtu për këtë lloj kategori prurjesh dispozitat kushtetuese kanë parashikuar edhe kushte ndaluese, mosplotësimi i të cilave sjell pengimin e tij për kandidim, (nuk duhet të ketë mbajtur funksione politike në administratën publike ose pozicione drejtuese në parti politike, gjatë dhjetë viteve të fundit).

Më tej në nenin 49 ligjvënësi ka përcaktuar mënyrën e vlerësimin të aftësive profesionale nëpërmjet dokumentacionit ligjor, vlerësimin të punës ndër vite dhe aftësinë në zotërimin e të paktën një gjuhe të huaj.

3. Në analizë të interpretimeve të mësipërm rezultojnë se magjistrati “prokuror” nuk është i përfshirë në kategorinë e parë të përcaktuar në dispozitën kushtetuese. Në këtë kategori ai nuk mund të kandidojë pasi kushtetutë bërësi ka përcaktuar si përbërje të Gjykatës së Lartë vetëm magjistratët “**GJYQTAR**”. Qëllimi i Kushtet bërësit marrë në konsideratë përbërjen e mëparshme ligjore të Gjykatës së Lartë dhe kufizimet aktuale rezultojnë të jetë krijimi i një përbërje të pastër vetëm me prurje nga kategoria e gjyqtarëve ( raporti 4/5).

Më tej ligji ka përcaktuar në dispozita të veçanta neni 48 dhe 49 rregullime specifike për kategoritë e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë me prurje nga magjistratët “gjyqtar” dhe ata të konsideruar si “jurist të spikatur”.

3.1.Më konkretisht në kategorinë e dytë Kushtet bërësi ka përcaktuar në mënyre shteruese dhe në *expressis verbis* se në të përfshihen vetëm “**JURIST TË SPIKATUR**” me përvojë të përqendruar avokati, veprimtari mësimdhënie/akademi, jurist të nivelit të lartë në administratën publike ose **në fusha të tjera të së drejtës** duke mos evidentuar në të cilësimin magjistratët “prokuror”. Këta të

fundit mund të kandidojnë vetëm nën kategorinë e juristeve të spikatur/jurist në fusha të tjera të së drejtës për të cilët ligji ka parashikuar si kritere minimum, **vjetërsinë 15 vjet dhe gradën shkencore në drejtësi.**

3. 2. Në rastin “de qua” kandidati {...} jo vetëm nuk ka dorëzuar një dokument “grade shkencore” por pranon faktin e mospasjes së saj duke e interpretuar plotësimin e saj me faktin e disponimit të titullit “magjistratë”.

3.3. E drejta për të kandiduar në zgjedhje është një e drejtë themelore, por jo absolute. Ligji parashikon një proces mbledhje faktesh dhe rrethanash të mbështetura në dokumentacionin zyrtar, por njëherësh ai garanton një proces të rregullt ligjor duke e detyruar kandidatin të depozitohet akte të nevojshme zyrtare që konfirmojnë plotësimin e kritereve ligjore. Për këtë qëllim kandidati {...} ishte i detyruar që ndër aktet e dorëzuar të depozitonte edhe dokumentin *grade shkencore në drejtësi* si pjesë e detyrimit individual për të përmbushur kriteret e nenit 136 të Kushtetutës si edhe të nenit 49 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” në bazë të së cilës është hapur konkurrimi nga Këshilli i Lartë Gjyqësorë dhe ka vijuar konkurrimin ky kandidat.

#### IV. KONKLUZIONE

1. Sa më lart, **Këshilli i Lartë Gjyqësor arrin në konkluzionin se kandidati, z. {...}, nuk plotëson kushtin e kandidimit për në Gjykatën e Lartë, atë të “mbajtjes gradë shkencore në drejtësi”,** përcaktuar në nenin 136, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në nenin 49, pika 1, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, **prandaj Këshilli është përpara rastit për të vendosur skualifikimin dhe përjashtimin e kandidatit nga procedura e emërimit në Gjykatën e Lartë ku ai ka konkurruar.**

2. Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson po ashtu se në rastin konkret **nuk është e nevojshme kryerja e procedurës së verifikimit për kushtet dhe kriteret e tjera ligjore të kandidimit për këtë kandidat,** përse kohë, sipas ligjit, mosplotësimi edhe i një kushti të vetëm këndimi pasjellë skualifikimin dhe përjashtimin e kandidatit nga procedurat e emërimit në Gjykatën e Lartë.

#### PËR KETO ARSYE

Mbështetur në pikën 3, të nenit 136, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në pika 1 dhe 5, të nenit 49 në lidhje me pikat 4, shkronja “c” dhe 6, të nenit 32, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në shkronjën “a”, pika 2, të nenit 61, në shkronjën “a”, të nenit 86 dhe nenet 97, 98 dhe 100, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe në shkronjën “e”, pika 12, Seksioni Ç, Kreu VI, të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për



gjqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, Këshilli i Lartë Gjyqësor,

## **V E N D O S I**

1. Skualifikimin dhe përjashtimin e kandidatit z. {...}nga procedura e emërimit në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr. 110, datë 09.07.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...}sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.
3. Kandidati ka të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve nga dita e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

## **PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**

### **MENDIM PAKICE**

**Në çështjen që i përket kandidatit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë z. {...}, jam kundër qëndrimit të shumicës, sipas Vendimit nr. 171, datë 11.09.2019, për skualifikimin dhe përjashtimin e këtij kandidati nga procedura e emërimit në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr.110, datë 09.07.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për sa më poshtë vijon:**

1. Sipas shumicës, kandidati z. {...} është në kushtet e skualifikimin dhe përjashtimin nga procedura e emërimit në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë të shpallur në fushën e të drejtës penale, mbi shkakun e mosplotësimit nga ai të kushtit të kandidimit “të mbajtjes gradë shkencore në drejtësi”, përcaktuar në nenin 136, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në nenin 49, pika 1, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Në arsyetimin e saj shumica pranon se kandidati, ndërsa nuk vjen nga radhët e gjyqtarëve për shkak se mban funksionin e prokurorit, duhet të plotësojë të gjitha kushtet e kandidimit të përcaktuara në dispozitat si më lart për kategorinë e “juristëve të spikatur”, ndër to edhe atë “të mbajtjes gradë shkencore në drejtësi”, kusht të cilin verifikohet se nuk e plotëson.

2. Sipas nenit 136 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë:

1. Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë emërohen nga Presidenti i Republikës, me propozim të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për një mandat 9-vjeçar, pa të drejtë riemërimi.
  2. Presidenti i Republikës, brenda 10 ditëve nga data e marrjes së vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, emëron gjyqtarin e Gjykatës së Lartë, me përjashtim të rasteve kur Presidenti konstaton se kandidati nuk plotëson kriteret e kualifikimit ose kushtet e zgjedhshmërisë, sipas ligjit. Dekreti i Presidentit të Republikës për mosemërimin e kandidatit humbet fuqinë kur kundër tij votojnë shumica e anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Në këtë rast, si dhe kur Presidenti nuk shprehet, kandidati shpallet i emëruar dhe fillon detyrën brenda 15 ditëve nga data e vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
  3. Gjyqtari i Gjykatës së Lartë zgjidhet nga **radhët e gjyqtarëve** me të paktën 13 vjet përvojë në ushtrimin e profesionit. **Një e pesta e gjyqtarëve në këtë gjykatë përzgjidhet mes juristëve të spikatur** me jo më pak se 15 vjet përvojë si **avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, juristë të nivelit të lartë në administratën publike ose në fusha të tjera të së drejtës.** Kandidatët që përzgjidhen nga radhët e juristëve duhet të kenë gradë shkencore në drejtësi.
  4. **Kandidati jo gjyqtar** nuk duhet të ketë mbajtur funksione politike në administratën publike, ose pozicione drejtuese në parti politike, gjatë 10 vjetëve të fundit para kandidimit. Kriteret e tjera dhe procedura e përzgjedhjes së gjyqtarit parashikohen me ligj.
  5. Gjyqtari i Gjykatës së Lartë qëndron në detyrë deri në emërimin e pasardhësit, përveç rasteve të parashikuara në nenin 139, paragrafi 3, nënparagrafët “c”, “ç”, “d” dhe “dh”.
3. Sipas nenit 49 (“Emërimi i kandidatëve jogjyqtarë në Gjykatën e Lartë”) të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”:
1. **Një e pesta e gjyqtarëve në Gjykatën e Lartë mund të përzgjidhen mes juristëve të spikatur,** që kanë gradë shkencore në drejtësi, me jo më pak se 15 vjet përvojë si **avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, juristë të nivelit të lartë në administratën publike ose në fusha të tjera të së drejtës.**
  2. **Kandidatët jogjyqtarë për pozicione në Gjykatën e Lartë duhet:**
    - a) të plotësojnë kriteret e përcaktuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "ë" dhe "f", të nenit 28, të këtij ligji;
    - b) të mos kenë mbajtur funksione politike në administratën publike, ose në pozicione drejtuese në parti politike, gjatë dhjetë viteve të fundit para kandidimit.
  3. ...
  4. **Këshilli i Lartë Gjyqësor publikon thirrjen për paraqitjen e kandidaturave, në përputhje me përcaktimet e bëra në pikat 3 dhe 5, të nenit 48, të këtij ligji.**
  5. **Këshilli vlerëson përmbushjen e kriterëve, sipas parashikimeve të pikës 2, të këtij neni, dhe verifikon kandidatët, sipas parashikimeve të pikave 2 deri në 7, të nenit 32, të këtij ligji. Kandidatët, të cilët nuk përmbushin kriteret ose nuk kalojnë procesin e verifikimit të pasurisë dhe të figurës, përjashtohen nga kandidimi.**
- ...

4. Sipas nenit 48 (“Ngritja në detyrë në shkallët më të larta ose të specializuara”) të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”:

**1. Pozicionet në Gjykatën e Lartë, Prokurorinë e Përgjithshme dhe gjykatat e posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar plotësohen nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë.** Pozicionet në gjykatat e tjera të apelit plotësohen nëpërmjet procedurave të lëvizjes paralele, në përputhje me nenet 42 dhe 43 të këtij ligji.

2. Në rastin kur ka shumë pozicione të lira, të cilat nuk plotësohen me lëvizje paralele, secili Këshill organizon një procedurë ngritje në detyrë për çdo pozicion të lirë, të paktën një herë në çdo tre muaj. Pozicionet plotësohen jo më vonë se tre muaj nga dita e shpalljes së procedurës.

**3. Këshillat shpallin procedurën e ngritjes në detyrë dhe bëjnë thirrje që të kandidojë:**

a) **magjistrati që plotëson kriteret për ngritjen në detyrë**, në përputhje me kërkesat e pozicionit të lirë të shpallur;

b) **magjistrati i komanduar ose magjistrati në skemën e delegimit që plotëson kriteret për ngritjen në detyrë**, në përputhje me kërkesat e pozicionit të lirë të shpallur;

c) **juristi i spikatur, sipas përcaktimeve të nenit 49 të këtij ligji.**

4. ...

5. Në zbatim të pikës 3, të këtij neni, shpallja publikohet të paktën në faqen zyrtare të Këshillit dhe duhet të përmbajë informacionin e nevojshëm për pozicionin e lirë, si dhe të përcaktojë:

...

5. Referuar përcaktimeve të bëra në pikën 3, të nenit 136 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nga interpretimi literal i normës, duket që kushtetubërësi ka përcaktuar dy burime nga mund të vijnë kandidatët për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, konkretisht nga radhët e gjyqtarëve dhe nga radhët e juristëve të spikatur. Sa i përket burimit “radhët e gjyqtarëve”, kjo është lehtësisht e identifikueshëm sepse norma është krejt e qartë. Ndërsa sa i përket burimit “radhët e juristëve të spikatur”, duket që kushtetubërësi, përmes normës, ka përcaktuar një listë profesionesh dhe pozicionesh, që në një pikëpamje mund të konsiderohet si listë shteruese. Në këtë listë kushtetubërësi nuk ka përfshirë nominalisht një nga nënkategoritë e profesionit të juristit, atë të prokurorit. Institucioni i prokurorisë është pjesë e administratës publike, por se pozicioni i prokurorit, si një nëpunës i këtij institucioni, mendoj se nuk mund të klasifikohet si pozicion specialist, duke iu referuar për këtë përcaktimeve të bëra në ligjin organik të këtij institucioni kushtetues, Ligjit nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”. Sipas këtij ligji, prokurori ka një status të veçantë, që rregullohet nga Ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, sipas të cilit prokurorët gëzojnë statusin e magjistratit, status ky i njëjtë me atë të gjyqtarëve. Pra, referuar statusit ligjor, mund të thuhet se prokurori nuk është specialist (qoftë dhe i lartë) në administratën publike. Thënë kjo, do të duhet të pranohet se kushtetubërësi, përmes përcaktimeve të bëra në pikën 3, të nenit 136, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ka përjashtuar nga “radhët e juristëve të spikatur” prokurorët, çka nuk mund të pohohet pasi do të përbënte një diskriminim të pastër për këtë kategori profesionistësh.

6. Gjithsesi dilemma e mësipërme bie nga përcaktimi i bërë në pikën 4, të nenit 136, të Kushtetutës, në të cilën bëhet fjalë për “jogjyqtarët”, pra përmes kësaj norme duket që kushtetubërësi ka ripërcaktuar burimin “radhët e juristëve të spikatur” me “jogjyqtarët”.

7. Sa më lart, nga interpretimi sistematik i pikave 3 dhe 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, duket që dy burime nga mund të vijnë kandidatët për gjyqtar në Gjykatën e Lartë janë përcaktuar nga kushtetubërësi nën emërtimin “radhët e gjyqtarëve” dhe “radhët e jogjyqtarëve”.

8. Megjithatë, vlen të theksohet se në kategorinë e “jogjyqtarëve” përfshihen edhe “prokurorët”, të cilët gëzojnë të njëjtin status ligjor si dhe “gjyqtarët”.

9. Mendoj se e njëjta problematike qëndron edhe sa i përket rregullimeve për ngritjen në detyrë të bëra në Ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, por me një veçanti se në rregullimet e bëra në nenin 47 (“Kriteret minimale të përvojës profesionale për ngritjen në detyrë”) të këtij ligji, sipas vlerësimit tim, ka një konfuzitet apo më saktë ka në mospëcaktim të qartë në lidhje me atë nëse karriera e gjyqtarëve dhe karriera e prokurorëve janë të ndara apo që mund të ndërthuren.

10. Në mënyrën se si janë formuluar rregullimet e bëra në nenin 47 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, sipas mendimit tim, mund të interpretohet se magjistratët mund të bëjnë karrierë të ndërthurur në të dy sistemet, atë gjyqësor dhe të prokurorisë. Nuk mund të them nëse kjo është zgjidhja më e mirë, por sa i përket Gjykatës së Lartë, pa asnjë dyshim mendoj se bërja karrierë e prokurorëve në organin më të lartë të pushtetit gjyqësor është mëse e përshtatshme dhe e pranueshme, pasi do të ishte një vlerë e shtuar për mirëfunksionimin e Gjykatës së Lartë, pikërisht të një prej seksioneve që ajo organizohet, atij penal, kuptohet brenda një numri të kufizuar dhe në respektim të raportit të përcaktuar nga Kushtetuta.

11. Konkretisht, sipas nenit 47 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”:

*1. "Ngritja në detyrë" është kalimi nga:*

*a) një pozicion në sistemin gjyqësor ose të prokurorisë, në një pozicion tjetër të një niveli më të lartë;*

*b) një pozicion i juridiksionit të përgjithshëm civil, penal ose administrativ në një pozicion në një prej gjykatave të posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar ose në Prokurorinë e Posaçme;*

*c) një pozicion si magjistrat, në pozicionin e kryetarit të një gjykate ose prokurorie;*

*ç) një pozicion i komanduar ose pozicion në skemën e delegimit, në një pozicion të një niveli më të lartë sesa pozicioni i mbajtur para komandimit.*

**2. Magjistrati ngrihet në detyrë nëse plotëson këto kritere minimale për përvojën profesionale:**

*a) për pozicionin gjyqtar në gjykatën e posaçme të shkallës së parë për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar, magjistrati duhet të ketë ushtruar funksionin*

*jo më pak se shtatë vjet si gjyqtar, nga të cilat të paktën pesë vjet si gjyqtar në fushën e drejtësisë kriminale ose si inspektor në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar;*

*b) për pozicionin gjyqtar apeli në Gjykatën e Posaçme të Apelit për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar, magjistrati duhet të ketë ushtruar funksionin jo më pak se dhjetë vjet si gjyqtar, nga të cilat të paktën pesë vjet si gjyqtar për çështjet penale ose si inspektor në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;*

*c) për pozicionin prokuror në Prokurorinë e Posaçme, magjistrati duhet të ketë ushtruar funksionin për jo më pak se dhjetë vjet si prokuror, duke përfshirë edhe përvojën si prokuror i komanduar.*

...

*4. Magjistrati mund të ngrihet në detyrë në pozicione pranë gjykatave ose prokurorive të shkallës së dytë, nëse ka ushtruar funksionin jo më pak se shtatë vjet në shkallën e parë, nga të cilat të paktën pesë vjet në fushën e së drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionin e lirë, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar.*

*5. Magjistrati mund të ngrihet në detyrë në pozicione pranë Gjykatës së Lartë dhe Prokurorisë së Përgjithshme, nëse ka ushtruar funksionin jo më pak se trembëdhjetë vjet në nivele më të ulëta, nga të cilat të paktën pesë vjet në fushën e së drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionin e lirë, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar.*

*6. Magjistrati mund të ngrihet në detyrë, në pozicionin e kryetarit të gjykatës ose prokurorisë së shkallës së parë ose të dytë, nëse:*

*a) ka ushtruar funksionin e magjistratit jo më pak se shtatë vjet, gjatë të cilës, të paktën katër vjet në të njëjtën shkallë, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar;*

...

12. Vlen të përmendet se ndërthurja e karrierave të gjyqtarëve dhe prokurorëve pranohet edhe nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.

12.1 Kështu, sipas pikës 3, të nenit 148/a, të Kushtetutës, “**Prokurori i Përgjithshëm zgjidhet nga radhët e juristëve të spikatur, me jo më pak se 15 vjet përvojë pune, me integritet të lartë moral dhe profesional, që kanë përfunduar Shkollën e Magjistraturës ose kanë një gradë shkencore në drejtësi**”. Sipas kësaj dispozite, Prokurori i Përgjithshëm, pra në pozicionin më të lartë të karrierës në sistemin e prokurorisë, mund të zgjidhet kushdo që ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës, domethënë çdo magjistrat, ndër ta edhe një gjyqtar, i cili plotëson kushtet dhe kriteret e tjera të kandidimit, me përjashtim të “mbajtjes gradë shkencore në drejtësi”.

12.2 Ndërsa, sipas pikës 5 të kësaj dispozite të Kushtetutës, “**Pas përfundimit të mandatit dhe me kërkesë të tij, Prokurori i Përgjithshëm emërohet në detyrën e mëparshme ose gjyqtar në gjykatën e apelit**”. Sipas kësaj dispozite, Prokurori i Përgjithshëm, i cili mund të zgjidhet edhe nga radhët e juristëve të spikatur, pra jo nga radhët e magjistratëve, në përfundim të mandatit gëzon të drejtën për t’u emëruar gjyqtar i nivelit të dytë.

13. Në konsideratë të sa më lart parashtrova, si dhe mbi një interpretim harmonik të dispozitave kushtetuese dhe Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, duke pranuar se Kushtetuta dhe ligji ndjekin të njëjtin standart barazie në të drejta për magjistratët (gjyqtarët dhe prokurorët), mendoj se prokurorët bëjnë pjesë në kategorinë e “juristëve të spikatur”/“jogjyqtarëve”, të cilët, sipas nenit 136, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, mund të emërohen gjyqtarë në Gjykatën e Lartë, por se ndryshe nga profesionistët e tjerë që përshihen në këtë kategori, për prokurorët nuk është kusht kandidimi “mbajtja gradë shkencore në drejtësi”.

**14. Për sa më sipër, shpreha qëndrimin dhe votova kundër propozimit për skualifikimin dhe përjashtimin e kandidatit {...} nga procedura e emërimit në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr.110, datë 09.07.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**

**ANËTAR**

**ILIR TOSKA**